



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

*Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit/
Ministarstvo Obrazovanja i Nauke, Tehnologije i Inovacija / Ministry of Education, Science,
Technology and Innovation*

Dokument konsultimi

Përmbledhje e shkurtër rreth draftit të Koncept dokument për Ligjin e Arsimit dhe Aftësisimit
Profesional në Republikën e Kosovës

Ky Koncept dokument është hartuar në zbatim të Vendimit të Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit Nr. 2-3316, dt. 01.11.2023, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta zyrtare nr. 70/01 mars 2019), si dhe nenit 8, paragrafi 5 i Rregullores nr. 13/1013 për shërbimin ligjor qeveritar.

Qëllimi i Koncept dokumenti është harmonizimi më i mirë i arsimit me nevojat e tregut të punës si dhe përmirësimi i qeverisjes, financimit dhe sistemit të menaxhimit të informatave të arsimit dhe aftësisimit profesional dhe arsimit për të rritur, konsolidimi i mekanizmave për sigurim të cilësisë në nivel qendror dhe në nivel të IAAP-ve, harmonizimi i kualifikimeve në arsimin dhe aftësisimit profesional, në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe sigurimi i mundësive për realizimin e mësimin praktik dhe funksionalizimi i shërbimeve të këshillimit dhe orientimit në karrierë.

Qëllimi i konsultimit

Gjatë hartimit të këtij Koncept dokumenti janë mbajtur një varg punëtorish me anëtarët e Grupit punues të emëruar me vendim të Sekretares së Përgjithshme.

Nga procesi i konsultimit presim të marrim propozime dhe opinionet nga të gjitha palët e interesit, në funksion të plotësimit dhe avancimit të mëtejshëm të draft-dokumentit, duke u siguruar që ky Koncept dokument ta arrijë qëllimin që ka.

Çka duhet të përmbajnë komentet

Emri i personit/organizatës që jep komente: Avni Gashi

Fushat kryesore të veprimit të organizatës: Ekspert per Sigurim te Cilesise ne Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve,

ish U.D Drejtor i AKK-se dy herë në periudha të ndryshme,

ish U.D Drejtor ne Agjensinë e Kosovës për Akreditim AKA.

Anëtar i Grupit Punues për hartim të Koncept dokumentit të AKA-se,

Anëtar i Grupit Punues për ligjin për AKA,

Anëtar i Grupit Punues për ligjin e Arsimit të Lartë,

Antëtar i grupeve punuese për legjislacionin primar dhe sekondar për të dy agjensionet respektive AKK&AKA.

Anëtar i grupeve punuese për plotësim ndryshim të Ligjeve për AAP dhe Ligjit për të Rritur sipas rekomandimeve të Raportit te Progresit nga Komisioni Evropian.

Anetarë i Këshillit për Arsim dhe Aftësim Profesional MASHT,

Anëtar i Këshillit Shtetëror për Sigurim të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar MASHT.

Anëtar i grupit zhvillues i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve.

Anëtar i grupit zhvillues per Kornizen Komëbetare per Sigurim te Cilesis (KKSC)

Anëtar dhe përfaqësoj AKK/Kosovën ne grupin zhvillues në Kornizën Evropiane të Kualifikimeve ne Komisionin Evropian KEK/EQF,

Anëtar /Kontakt Person Kombëtar (NCP) ne rrjetin Evropian për Sigurim të Cilësisë ne Arsimin Profesional (EQAVET),

Anëtar NCP për shume vite ne rrjetin e Fondit Evropian te trajnimeve (ETF).

Informatat e kontaktit të organizatës (adresa, e-mail, telefoni): avni.gashi@rks-gov.net

Komentet: Si pjesë e stafit profesional të AKK që nga themelimi i AKK. Unë në kuadër të këtij konsultimi publik shpreh mendimet e mijë profesionale si rezultat i përvojës shume vjecare në këtë institucion,

Me posht i gjeni të listuara të gjitha komentet e ndara ne kapituj, paragrafe dhe faqet përkatëse në dokument.

Përmbledhje e konceptdokumentit

Faqe 12 -Figura 1: Dokumentet përkatëse të politikave, ligjet dhe aktet nënligjore

Ligji për arsimin dhe aftësimin për të rritur në Republikën e	https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2868	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë	Rregullon tërësinë e proceseve për arsimimin dhe aftësimin e të rriturve, si pjesë përbërëse e sistemit arsimor në Kosovë. Programet, kualifikimet dhe modulet e arsimit dhe aftësimit për të
--	---	---	--

<p>Kosovë (Nr. 04/L-143)</p>		<p>dhe Inovacionit</p> <p>&</p> <p>Agjencia e Arsimit dhe Aftësimi Profesional për të Rritur</p>	<p>rritur, i hartojnë MASHTI, institucionet dhe ofruesit tjerë përkatës, varësisht prej interesave dhe veprimtarisë së tyre me orientim në tregun e punës.</p> <p>Ofruesit e arsimit dhe të aftësimi formal, i hartojnë programet dhe modulet e tyre, të cilat i akrediton AKK dhe i miraton MASHTI. Standardet e profesionit zhvillohen në bashkëpunim me MASHTI-n, AKK, MPMS, ministrinë tjera relevante dhe partnerët social.</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ Standardet e profesionit miratohen nga KAAPRr. ✓ Verifikimin e standardeve profesionale e bën AKK
-------------------------------------	--	--	--

Komenti: Lidhur me këtë neni 12.1 i këtij ligji përcakton se 1. Standardet e profesionit zhvillohen në bashkëpunimin me MASHT-in, AKK, MPMS, ministrinë tjera relevante dhe partnerët social. Andaj nuk është pasqyruar qartësisht roli që ka AKK në procesin e akreditimit që në fakt nënkupton se funksionon si agjenci rregullatorë, njëjtë sikurse Agjencia e Akreditimit të Kosovës, kjo në frymën e Ligjit PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E ADMINISTRATËS SHETËRORE DHE TË AGJENCIVE TË PAVARURA në fuqi. Këtu nuk është pasqyruar qartë roli i AKK, për arsye se nga Ligji për Arsimin Profesional, buron qartësisht fushëveprimi i AKK që lidhet me pjesën e cilësisë, bazuar edhe në nenin 25 të këtij ligji por edhe në nenet e tjera.

Faqe 12

<p>Ligji për kualifikime kombëtare (Nr. 03/L- 060)</p>	<p>https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2606</p>	<p>Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit</p>	<p>Krijon Sistemin Kombëtar të Kualifikimeve, që bazohet në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK), të rregulluara nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK).</p>
---	--	--	--

		& Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve	
--	--	--	--

Komenti 1: Duhet theksuar që Ligji për Kualifikimet Kombëtare në qëllimin e tij përcakton: “1. Qëllimi i këtij ligji është krijimi i Sistemit Kombëtar të Kualifikimeve, që bazohet në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK), të rregulluara nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK)”. Kjo nënkupton që Ligji për Kualifikimet Kombëtare është i lidhur direkt me Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve cila rregullohet nga AKK, sipas këtij ligji. Ky dokument duhet të theksoj që Korniza Kombëtare e Kualifikimeve (KKK) prek edhe arsimin e lartë dhe të gjitha nivelet e arsimit, respektivisht të gjitha fushat e arsimit. Duke qenë kështu, duhet të theksohet se ky ligj përfshihet në fushën e arsimit dhe në kuadër të ligjeve me interes vital. Fuzionimi eventual i mekanizmave të arsimit profesional gjerësisht AKK, kërkon edhe zhbërjen ose shfuqizimin e tërësishëm të Ligjit për Kualifikimet Kombëtare, për shkak se në atë ligj dhe ligje tjera shumë kompetenca i atribuohen AKK. Për shkak të argumentit të lartshënuar dhe faktin që Ligji për Kualifikimet Kombëtare lidhet me KKK dhe preke të gjithë fushën e arsimit, e bën këtë ligj një ligj me interes vital që proceduralisht kërkon ndryshim ose shfuqizimin e tij me procedure të veçantë. Në rast të fuzionimit të mekanizmave, në asnjë rast AKK nuk mund ti bashkëngjitet asnjë mekanizmi ose agjencie tjetër, në rast se ekziston në fuqi Ligji për Kualifikimet Kombëtare. Andaj, ky fakt duhet të theksohet në këtë dokument dhe të mos pasqyrohet vetë parcialisht roli i AKK.

Koment 2: Nuk janë pasqyruar qartë funksionet e AKK që i bartë ligji për Kualifikimet Kombëtare, rolin dhe përgjegjësitë. Ky ligj themelon AKK, duke i dhënë përgjegjësi të caktuara për zhvillimin e KKK. Përveç, kësaj ky ligj e përcakton qartësisht rolin e AKK dhe se nga të gjitha mekanizmat e tjerë të arsimit profesional, AKK është e vetmja që i ka të qartësuara kompetencat, fushëveprimin dhe rolin e saj me Ligjin për Kualifikimet Kombëtare si dhe Ligjin për Arsimin dhe Aftësimin Profesional.

Faqe 13: Ligjet që lidhen me arsimin dhe aftësimin profesional

Komenti: Duhet theksuar se jo të gjitha ligjet lidhen me arsimin profesional, andaj duhet të merret me kujdes këtu kur përmendet Ligji për Arsimin e Lartë ose ai për Agjencinë e Akreditimit etj. Gjithashtu, në këtë pjesë duhet të theksohet se të gjitha këto ligje të fushës së arsimit i përkasin kësaj fushë si ligje me interes vital.

Faqe 13 dhe 14: Ligji për Kualifikime Kombëtare (Nr. 03/L- 060) i cili rregullon zhvillimin dhe mirëmbajtjen e Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve dhe dhënien e kualifikimeve për të cilat autorizon Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve (me

përrjashtim të kualifikimeve që rregullohen sipas dispozitave të Ligjit për Arsimin e Lartë). Ligji rregullon gjithashtu ngritjen e Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve dhe funksionet e tij.

Komenti: Në pjesën ku paraqiten Ligjet që lidhen me arsimin dhe aftësimin profesional nuk specifikohet qartë cka përcakton ligji për KK në lidhje me AKK. Kjo nuk përfaqëson qartë strukturën, funksionet e AKK sipas LKK. Këtu duhet të paraqitet me qartësisht roli i AKK, sidomos në Ligjin për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe në Ligjin për Kualifikimet Kombëtare, roli i AKK është crucial dhe se duhet të pasqyrohet me thellësisht, sepse është i vetmi institucion në arsimin profesional që ka kompetenca akredituese dhe që në relacion me Ligjin për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencive të Pavarura funksionon si agjenci rregullatore. Mosparaqitja e rolit të AKK në mënyrë të qartë, vë në pikëpyetje saktësinë dhe objektivitetin e dokumentit dhe pasqyrimin e saktë të rolit të AKK, në fushën e arsimit profesional.

Konteksti legjislativ i ndërlidhur me acquis

Faqe 16- Konteksti legjislativ i ndërlidhur me acquis

Komenti- Ndërlidhur me politikat me BE gjeni të listuara më poshtë raportet dhe rezultatet e AKK.

- Korniza Kombëtare e Kualifikimeve (KKK) është hartuar në vitin 2011 nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK), me mbështetjen e projektit “EU KOSVET -V-” dhe me financim nga Bashkimi Evropian (BE)
- Procesi i referimit të Kornizës Kombëtare e Kualifikimeve në Kosovë ka përfunduar në vitin 2016.
- Në vitin 2019 është prezantuar raporti i njëfishtë për NjMP, ky dokument është zhvilluar me mbështetje të ETF dhe nëpërmjet këtij raporti AKK paraqet vështrimin mbi gjendjen aktuale dhe nismat e ndërmarra në lidhje me sistemin e Njohjes së Mesimit Paraprak në Kosovë. Kosova është vendi i 11-të që ka paraqitur këtë raport pranë Grupit Këshillues (Advisory Group AG) të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve (EQF).
- European inventory of NQFs
 - 2022- <https://ëëë.cedefop.europa.eu/en/country-reports/kosovo-european-inventory-nqfs-2022>
 - 2020- <https://ëëë.cedefop.europa.eu/en/country-reports/kosovo-european-inventory-nqfs-2020>
 - 2018- <https://ëëë.cedefop.europa.eu/en/country-reports/kosovo-european-inventory-nqf-2018>
 - 2016- <https://ëëë.cedefop.europa.eu/en/country-reports/kosovo-european-inventory-nqf-2016>
- European inventory on validation of non-formal and informal learning

- 2018- <https://ëëë.cedefop.europa.eu/en/country-reports/european-inventory-validation-non-formal-and-informal-learning-2018-update-kosovo>
- 2023- <https://ëëë.cedefop.europa.eu/en/country-reports/european-inventory-validation-informal-and-non-formal-learning-2023>

Faqe 16- Harmonizimi i ligjeve në fushën e arsimit dhe aftësimit profesional është gjithashtu një obligim i Republikës së Kosovës që buron nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit.

Komenti: Marrëveshja për stabilizim asociim nuk i referohet specifikisht harmonizimit të ligjeve në fushën e arsimit profesional dhe se kjo nuk duhet të thuhet kështu, sepse merr një kontekst shumë të gjerë.

Faqe 16- Marrëveshja e Stabilizim Asociimit në nenin 107 për fushën e arsimit dhe aftësimit thekson se palët do të bashkëpunojnë me qëllim të ngritjes së nivelit të arsimit të përgjithshëm dhe arsimit dhe aftësimit profesional, si dhe politikave rinore dhe punës rinore në Kosovë, si mjete për të promovuar zhvillimin e aftësive, punësueshmërinë, përfshirjen sociale dhe zhvillimin ekonomik në Kosovë. Palët gjithashtu do të bashkëpunojnë me qëllimin për të siguruar që qasja në të gjitha nivelet e arsimit dhe trajnimit në Kosovë të jetë pa diskriminim në bazë të gjinisë, origjinës racore ose etnike, fesë ose besimit, paaftësisë, moshës ose orientimit seksual. Bashkëpunimi do të synojë të adresojë nevojat e nxënësve me aftësi të kufizuara në Kosovë.

Komenti: Në dokument duhet të përcaktohet se cila është relevanca e nenit 107 të marrëveshjes në raport me këtë dokument sepse kështu nuk është fakt.

Faqe16- Më 24 nëntor 2020, Këshilli i BE-së miratoi një Rekomandim për arsimin dhe aftësimin profesional për konkurrencë të qëndrueshme, drejtësi sociale dhe fleksibilitet.

Komenti: Nuk po përshkruhet qartë rekomandimet e Këshillit të BE dhe zhvillimet në Kosovë lidhur me këto rekomandime: si Establishment of a European Quality Assurance Reference Framework for Vocational Education and Training ('EQAVET' Adaptimi i sistemit të kredive në AAP sipas ECVET; Zhvillimi i sistemit formal, jo formal dhe informal në nivelet e Kornizës Europiane të Kualifikimeve, pra zhvillimi i sistemin të Njohjes së Mësimi Paraprak, etj; Zhvillimi i programeve të AAP në nivelin V të kualifikimeve të KKK.

Faqe 16- Rekomandimet që dalin nga një analize e përputhshmërisë së reformës me acquis janë:

Komenti: Cila analizë, s'ka reference në analizën e përshkruar. Duhet saktë të referencohet analiza, sepse si i tillë dokumenti mund të paraqitet me pasaktësi apo është analizë individuale.

Faqe 16- Ofrimi i një niveli autonomie për IAAP-të për t'i lejuar ata të reagojnë shpejt ndaj sfidave të aftësive, të ofrojnë programe të shpejta të rikualifikimit dhe të punojnë në partneritete të ngushta me punëdhënësit nga sektori publik dhe privat;

Komenti: Sipas sistemit te kualifikimeve qe ofron Korniza Kombëtare e Kualifikimeve nga praktika është shume e qarte qe e ka ofruar këtë mundësi te zhvillimit te programeve/kualifikimeve/moduleve te shkruara për qëllime punësimi, apo certifikimi me një pjese te programit/kualifikimit, Njohjen e Mësimi Paraprak, etj. Shume nga IAAP publike kane filluar te zhvillojnë një praktike te tille, e numri I IAAP private dhe ofruesve te tjerë qe ofrojnë kualifikime te tilla është relativisht i madh.

Faqe 16- Modularizimi i programeve të arsimit dhe aftësimi profesional dhe zgjerimi i tyre në nivele më të larta të kualifikimeve;

Komenti: Te gjitha programet e AAP janë te bazuara ne Rezultate Mësimore dhe struktura e tyre është modulare. Po ashtu ne këto vitet e fundit është rritur edhe numri i kualifikimeve të Nivelit të V të KKK, një mundësi e cila nuk ka qene prezentë tek IAAP.

Faqe 16- Parimet, kriteret dhe treguesit e cilësisë në KKSC duhet të thjeshtohen, të bazohen në rezultate dhe të harmonizohen më mirë me EQAVET.

Komenti: KKSC fillimisht është zhvilluar me mbështetjen e BE, konkretisht Projekti EU KOSVET V, ku të gjitha kriteret janë në përputhje me Kornizën Evropiane për Sigurim të Cilësisë. KKSC është rishikuar me kalimin e kohës dhe është marr parasysh thjeshtimi dhe fuzionimi i disa kriterëve/ treguesve brenda principeve/ parimeve të KKSC duke ju përmbajtur udhëzimeve evropiane pasi që AKK ka përfaqësim të rregullt me EQAVET dhe është në harmoni me ndryshimet e fundit të cilat bëhen në këtë rrjet. Së fundi, KKSC është rishikuar me ndihmën e GIZ në fund të vitit 2022, me qëllim te thjeshtimit të kriterëve dhe treguesve sipas trendeve të fundit të zhvillimeve evropiane, proces ky që ka përfshirë të gjitha palët që preken nga ky mekanizem si pjese e sistemit të AAP, institucionet relevante qendrore, agjencitë, përfaqësues nga industria dhe ofruesit e IAAP.

Përvojat nga vende të tjera

Faqe 17- Në vitin 2009, Estonia ka themeluar Agjencinë EKKK (Agjencia Estoneze e Cilësisë për Arsimin e Lartë dhe Profesional) tashmë e quajtur HAKA (Agjencia Estoneze e Cilësisë për Arsimin) e cila është qendra kryesore e kompetencave në fushën e arsimit në Estoni. Misioni i HAKA-s është të fuqizojë institucionet arsimore dhe palët e tjera të interesuara në avancimin e cilësisë së të nxënësve dhe mësimdhënies, si dhe mbështetjen e zhvillimit të nxënësve. Në nivel kombëtar, oda ekonomike, konfederata e punëdhënësve dhe konfederata e sindikatave të tregtisë përfaqësojnë partnerët socialë. Punëdhënësit luajnë një rol aktiv dhe me ndikim në këshillat profesionale dhe zhvillimin e standardeve për çdo profesion. Në nivel lokal, partnerët social marrin pjesë në bordet këshilluese të shkollave të AAP-së.

Komenti: Këtu nuk po përmendet institucioni tjetër në kuadër të sistemit Estonez, i cili është KUTSEKODA përgjegjës për kualifikimet dhe Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve në Estoni, përfshirë ato të AAP dhe AL pra është rasti i ngjashëm sikurse edhe i Kosovës, që Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve e lidhin me një institucion, siç është këtu AKK.

Andaj, këto informacione të paraqitura duhet të krahasohen edhe me realitetin e Kosovës dhe të paraqiten ashtu siç janë, pa deformime të tilla.

Faqe 17- Sistemi kroat i AAP-së përfiton nga një agjenci e fortë e AAP-së, ASOO. Pra, ekziston një institucion qendror që formëson AAP-në në vend. Sipas sistemit Kroat të AAP, një agjenci mund të punojë më ngushtë me palët e përfshira, veçanërisht me punëdhënësit, sesa që mundet një ministri.

Komenti: Agjencia e referuar në këtë pjesë ASOO, nuk bënë vlerësimin e jashtëm të institucioneve dhe programeve. Kjo Agjenci, po ashtu, nuk mbulon sistemin e vlerësimit të jashtëm për kualifikimet joformale, andaj duhet të paraqitet më saktë këtu dhe drejtë.

Faqe 17- Shqipëria po ashtu ka të themeluar AKAFPK-në (Agjencinë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve) i cili është institucioni publik përgjegjës për përmirësimin e arsimit dhe aftësimin profesional, por e cila ka përgjegjësi të shumta, duke u përballur me sfida thelbësore që mes tjerash kanë të bëjnë me financimin e institucionit dhe kualifikimin e punonjësve. Ky është institucion vartës i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Komenti: Në paraqitjen e AKAFPK, theksohet se ky institucion nuk ka kompetenca vlerësimi të jashtëm, edhe pse ka tendenca të tilla në vitet e fundit, por në legjislacionin e tyre kanë vetëm performancën e shkollave dhe jo vlerësimin e programeve si dhe nuk e përfshinë sistemin jo formal të kualifikimeve, një prej elementeve të zhvilluara nga AKK në nivel vendi dhe rajoni.

Faqe 18- *Sa i përket Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK), në të gjitha përvojat e analizuara, këto janë disa nga ngjashmëritë dhe dallimet që ndërlidhen edhe me rolin e KKK në Kosovë:*

- Korniza e Kualifikimeve të Estonisë (EstQF) me tetë nivele u krijua në 2008, me Ligjin e Kualifikimeve Profesionale. EstQF ka 8 nivele, përshkrimet e niveleve të kualifikimit janë identike me përshkrimet e nivelit të KEK. Kualifikimet e AAP janë të shtrira në nivelet 2-5 të EstQF. EstQF është një kornizë gjithëpërfshirëse, e përbërë nga katër nën-korniza për:
 - kualifikimet e arsimit të përgjithshëm;
 - kualifikimet e AAP-së;
 - kualifikimet e arsimit të lartë;
 - kualifikimet profesionale.

Komenti: Duhet të theksohet se KKK e Estonisë menaxhohet nga tjetër institucion pavarësisht agjencisë së AAP, kjo me qëllim që dokumenti të paraqet të dhëna të sakta pa deformime të tilla.

Faqe 19- Në Shqipëri qeverisja dhe mbikëqyrja e Kornizës Kombëtare Shqiptare, përfshin disa institucione kryesore, përkatësisht Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencinë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve. Këto institucione marrin kolektivisht përgjegjësinë për zbatimin dhe

mirëmbajtjen efektive të KSHK-së. Pra, në Shqipëri nuk është themeluar një organ zyrtar i veçantë për mbikëqyrjen e KSHK-së. Mirëpo, duke njohur sfidat dhe kompleksitetin e gjatë të zbatimit të KSHK-së, si Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ashtu edhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë kanë krijuar një task-forcë. Kjo iniciativë bashkëpunuese, e mandatuar për një periudhë dyvjeçare sipas një Urdhri të përbashkët të Ministrave, synon t'i adresojë vështirësitë e identifikuara dhe të sigurojë mbarëvajtjen e procesit të zbatimit të KSHK-së në bashkëpunim me AKAFPK-në.

Komenti: Korniza Kombëtare Shqiptare nuk përfshinë të gjithë sistemin e kualifikimeve, nuk është në fazë zbatuese të KKSH.

Faqe 20: Shkaqet

Shkaqet	1. Dyfishim i përgjegjësive në fushën e AAP-së.
----------------	---

Komenti: Nuk ka një përshkrim dhe analizë të qartë për të paraqitur dyfishimin e përgjegjësive në AAP. Nga perspektiva e AKK nuk ka asnjë funksion të njëjtë që zbatohet nga ndonjë institucion tjetër në Kosovë. Kompetencat dhe përgjegjësitë janë të qarta me ligje dhe akte nënligjore, nuk ka në asnjë rast ndonjë duplikim të kompetencave, sidomos tek rasti i AKK.

Faqe 21 dhe 22

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve		Mungesë e një sistemi të kontrollit të cilësisë dhe përdorim të tij në zhvillimin e mëtejshëm të sistemit të kualifikimeve të mësimdhënësve;	Përgjegjësi administrative e agjencisë
-------------------------------------	--	--	--

Komenti: Kjo totalisht është vlerësim i gabuar sepse zhvillimi i mëtejshëm i sistemit të kualifikimeve të mësimdhënësve nuk është përgjegjësi e AKK, ashtu sic e keni paraqitur gabimisht. Kjo është kryekëput përgjegjësi e MASHT, DKA dhe Inspektoriati SIA - MASHT.

Faqe 21 dhe 22

<p>Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsimin e të Rriturve</p>	<p>Mungesë e një zingjiri koherent të kontrollit të performancës së bazuar në rezultate; Një tërësi aktesh legislative të paharmonizuara dhe të shpërndara në shumë instrumente;</p>	<p>Shkëputje e lidhjes së programeve të arsimit dhe aftësimin profesional me kërkesat e kohës së sotshme të tregut të punës;</p> <p>Mungesë e një sistemi të kontrollit të cilësisë dhe përdorim të tij në zhvillimin e mëtejshëm të sistemit të kualifikimeve të mësimdhënësve;</p>
<p>Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve</p>	<p>Mungesë e një zingjiri koherent të kontrollit të performancës së bazuar në rezultate</p>	<p>Shkëputje e lidhjes së programeve të arsimit dhe aftësimin profesional me kërkesat e kohës së sotshme të tregut të punës;</p> <p>Mungesë e një sistemi të kontrollit të cilësisë dhe përdorim të tij në zhvillimin e mëtejshëm të sistemit të kualifikimeve të mësimdhënësve;</p>

Komenti: Argumentet për AKK dhe AAAPRr, nuk duhet të paraqiten si të njëjta. Këto dy institucione janë krejt të ndryshme për nga kompetencat, andaj për këto nuk mund të vlejnjë argumente identike. Kështu siç janë paraqitur argumentet në mes të AKK dhe AAAPRr, krejtësisht identike, është diskriminuese dhe vlerësim i lexim jo i sakte dhe jo profesional i ligjeve në fuqi.

Ky portretizim identik, në mes të dy institucioneve të ndryshme me kompetenca, është kundërligjor dhe përbën një pasqyrim krejtësisht të gabuar të ligjeve në fuqi, sidomos Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional si dhe Ligjit për Kualifikimet Kombëtare.

Kapitulli 2: Objektivat

Faqe 23: Objektivi 3: Harmonizimi i ligjeve të fushës së arsimit dhe aftësimin profesional në një akt ligjor

Komenti : Nuk mund të ketë harmonizim të ligjeve, ligjet si të tilla, paraqesin saktësisht kompetencat e të gjitha institucioneve që kanë rol në fushën e arsimit profesional. Nga ajo që është thënë më sipër në dokument dhe nga kjo çfarë kërkohet tani, me harmonizim paraqitet një shpërputhje shumë e madhe dhe se kjo shpërputhje ka të bëjë me faktin se në pjesët e tjera, ajo çfarë është kërkuar nënkupton ndryshim rrënjësor të ligjeve që nuk mund të arrihet me harmonizim. Harmonizimi i ligjeve sidomos nuk mund të prek Ligjin për Kualifikimet Kombëtare, i cili prek të gjitha nivelet e arsimit.

Faqe 23: Objektivi 4: Krijimi i mekanizmave të pavarur me përgjegjësi për akreditim e IAAP-ve në kuadër të agjencisë

Komenti : Kjo është në kundërshtim me Ligjin Për Organizimin Dhe Funkcionimin E Administratës Shtetërore Dhe Të Agjencive Të Pavarura, respektivisht me nenet 24, 25, 26, 27, etj, sepse nuk lejojnë krijimin e agjencisë mbi agjenci. AKK, për shembull sipas ligjeve në fuqi për kualifikimet kombëtare, funksionon saktësisht në sensin e një agjencie.

Kapitulli 3.3: Adresimi i reformës së strukturës institucionale të arsimit dhe aftësisë profesionale dhe KKK-së në Republikën e Kosovës përmes plotësimit-ndryshimeve të ligjeve individuale ((Opsioni i tretë))

Faqe 26: Një fuzionim i tillë është në përputhje me pritjet e Bashkimit Evropian në kuptim të Reformës së Administratës Publike , në të cilën MASHTI ka detyrim që të zvogëlojë numrin e agjencive ekzekutive për së paku një

Komenti : AKK nuk është një agjenci ekzekutive, sepse vepron në marrëdhënie me Zyrën e Kryeministrit sipas Ligjit për Kualifikime Kombëtare, andaj, duhet pasur kujdes në rastin e AKK, të mos përzihet obligimi dhe lidhja e AKK me agjenci ekzekutive, për shkak se AKK, në kuptim të Ligjit të aplikueshëm është një agjenci rregullatore, e njëjtte sikurse Agjencia e Kosovës për Akreditim.

Faqe 26: Përmes ligjit të ri do të parashihet themelimi i një trupe të pavarur, që reflekton përfaqësimin e tre palëve relevante për AAP-në, përkatësisht industrinë, nxënësit dhe autoritetin publik, dhe e cila do të vishet me kompetencën për të akredituar institucionet arsimore të AAP-së,

Komenti: Kjo është qasje jo e qëndrueshme dhe nuk ka një praktikë të tillë në asnjë vend me traditë në sigurimin e cilësisë dhe njëkohësisht krijon një konflikt të pavarësisë si dhe mundësisë se daljes jashtë kontrollit.

Në një agjenci e cila zhvillon programet, menaxhon me cilësinë e AAP, të jetë njëkohësisht përgjegjëse për vlerësimin e jashtëm, kjo totalisht është në konflikt të vazhdueshëm të kompetencave dhe interesit.

Faqe 26 dhe 27: Pavarësia e trupës së tillë do të sigurohet edhe përmes pamundësisë së shkarkimit të anëtarëve të saj, pos për arsye që lidhen me shkelje serioze të ligjit.

Komenti: Kjo është jashtë parimeve demokratike, ky funksion bie ndesh me Ligjin për Procedurën e Pergjithshme Administrative (LPPA), dhe është e rregulluar çështja e organeve kolegjiale dhe përfaqësimi i tyre.

Faqe 29: Opsioni nr. 3

Figure 8: Ndikimet më të rëndësishme të identifikuara për kategorinë e ndikimit

Ndikimet kryesore të pritshme

Ndikimet ekonomike	Zbatimi i konceptdokumentit sipas këtij opsioni do të ketë ndikim pozitiv në ekonominë e vendit. Ai do të mundësojë një ndërlidhje më të mirë të arsimit dhe aftësisë profesionale me nevojat e tregut të punës dhe industrive prodhuese e shërbyese në Kosovë. Një rritje e harmonizimit ndërmjet të dyjave do të rrisë eficiencën e parasë publike, të rrisë produktivitetin e ekonomisë vendore dhe të sistemit arsimor në përgjithësi. Gjithashtu, fuzionimi i agjencive do kontribuojë në komplementimin e shërbimeve të të dyja institucioneve paraqara në një të vetëm, faktor i cili do ndikojë në zhvillimin e fuqisë punëtore.
--------------------	--

Komenti: Nuk është përshkrim i qëndrueshëm, për shkak se fakti që propozimi i fuzionimit do të krijojë në zhvillimin e fuqisë punëtore nuk qëndron, për shkak se me këtë propozim humbet komponenti i cilësisë së jashtme të produkteve dhe shërbimeve të IAAP, duke marrë parasysh faktin se opsioni i zhvillimit dhe vlerësimit duhet të ketë pavarësi institucionale dhe krijimi i një trupe në mes do të krijojë situatë jo stabile duke mos marrë parasysh përvojën e AKK në procesin e vlerësimit. Vendosija e një trupe të tretë në këtë, është shumë e pa qartë dhe krijon hapësirë të dyshimit të kontrollit, e cila nëse jep llogari agjencisë së përbashkët, atëherë si mund të jete organ i pavarur?

Duhet pasur parasysh edhe faktin se nuk mund të kërkohet një fuzionim i agjencive që kanë një fushëveprim të ndryshëm ligjor dhe se duhet pasur kujdes në rolin ligjor që e ka AKK, sidomos në raport me Ligjin për Kualifikime Kombëtare.

Data e dërgimit të komenteve:

15.05.2024